**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER BELINDA V. ÇELAJ**
**ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.3/118**
**TEL: 0692077776**

# MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE SIGURUESE MBI 20,000,000 LEKË)

**Nr. repertori: 4233** **Nr. koleksioni: 1241**

**Tirane më 06/11/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20230503101394 17726

OTER
TIRANË

A20230503101394177726

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE**
**ZYRA VENDORE** Tirane
**NR.** 4233 **REP.**
**NR.** 1241 **KOL.**

## MARREVESHJE SIGURUESE

*Sot, me* 06/11/2023*..., ne* Tirane*........, perpara meje noteres* Belinda Celaj*..., u paraqiten personalisht palet e meposhtme, te cilet deklarojne perpara meje se me vullnetin e tyre te lire lidhin kete Marreveshje Siguruese si me poshte:*

**BARREDHENESI**: Shoqeria **HP VENDRESH ENERGY SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L39604402S, me seli dhe adrese ne Berat, Çorovode, Komuna Qender, Buzuq, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **z. Joni Misir Dyrmishi**, shtetas Shqiptar, lindur me date 26.05.1994, ne Çorovodë, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 036386211, me Nr. Personal J40526003V, leshuar ne date 03.09.2020 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakeve te shoqerise Nr. 4230 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Barredhenes.**

**BARREDHENESI**: Shoqeria **2RC SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT K82303007K, me seli dhe adrese ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Pashko Vasa, Pallati Nr. 8, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **z. Bardhyl Hasan Hysenbelliu**, shtetas Shqiptar, lindur me date 27.05.1967, ne Potom, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 033761089, me Nr. Personal G70527056Q, leshuar ne date 01.11.2018 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr. 4227 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Barredhenes.**

**BARREDHENESI**: Shoqeria **JDS SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L38912401L, me seli dhe adrese ne Berat, Çorovode, Skrapar, Lagja Çlirimi, banese private, perballe tregut, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **z. Misir Jaçe Dyrmishi**, shtetas Shqiptar, lindur me date 27.10.1964, ne Çorovodë, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 038819230, me Nr. Personal G41027042H, leshuar ne date 03.03.2023 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr. 4229 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Barredhenes.**

**BARREMARRES**: **Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA,** regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendim nr. 35506, date 19.04.2006 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, NIPT K72014801J, me seli ne adresen Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tirane, e perfaqesuar rregullisht nga **z.** Tsvetan Ivanov, shtetas Bullgar, ne cilesine e CRO & Drejtorit Ekzekutiv dhe **z.** Gledis Hysenaj, shtetas Shqiptar, ne cilesine e Drejtorit te Biznesit, te dy madhore, me zotesi te plote per te vepruar, te quajtur ne vijim **Banka / Barremarres.**

**PRANUESI I BARRES**: Shoqeria **AG Hpower & Construction SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B, me seli dhe adrese ne Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier – Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **znj. Nekida Ardjan Baha**, shtetase Shqiptare, lindur me date 25.08.1995, ne Xibrakë, mbajtese e leternjoftimit me Nr. 033292573, me Nr. Personal J55825018O, leshuar ne date 13.01.2017 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr. 4231 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim "**Pranuesi i Barres**".

MEQENESE

(A) Me date 06.11.2023, eshte nenshkruar nje Kontrate Kredie Bankare Nr. 4232 Rep., Nr. 1240 Kol., Ref. Nr. **000KR-AA-2233,** e noter Belinda Celaj (bashkangjitur kesaj marreveshje) midis Barremarresit ne kete kontrate dhe kredimarresit Shoqeria AG Hpower

A2023050310139417726

& Construction SHPK, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B, dhe dorezanesi Arben Pandi Goga, (te quajtur Kredimarres / Dorezanes/ Pranuesi i Barres), me qellim levrimin ne llogarine rrjedhese te Kredimarresit, prane Barremarresit te shumes ne total prej 60,500,000 Leke (gjashtedhjete milion e peseqind mije leke).

(B) Kontrata e Kredise Bankare eshte miratuar kundrejt ofrimit te garancive te nevojshme te ofruara nga Barredhenesi, per te siguruar permbushjen e plote te detyrimeve qe rrjedhin nga Kontrata e Kredise Bankare dhe Anekset e saj, nder te tjera, do te vendose barre siguruese mbi pasuri te luajtshme qe ndodhen ne pronesi te tij.

(C) Cdo garanci vendosur (pasurite e paluajtshme/paluajtshme) ne favor te Bankes me qellim garantimin e kesaj Kontrate Kredie Bankare do te sherbeje si garanci reale per detyrimet e Kredimarresit te rrjedhura nga cdo Kontrate tjeter Kredie Bankare dhe anasjelltas. Ne rast ekzekutimi te detyrueshem per nje nga Kontratat e Kredise Bankare, Kredidhenesi ka te drejten qe sipas vendimit te tij te vetem, te filloje ekzekutimin e detyrueshem kundrejt çdo garancie tjeter te vendosur me qellim garantimin detyrimeve te rjedhura nga cdo Kontrate tjeter Kredie Bankare.

DUKE PATUR PARASYSH SA ME SIPER, Barredhenesi dhe Barremarresi bien dakort per sa vijon:

**Neni 1**

**INTERPRETIMI**

1.1 PERKUFIZIME

Ne kete marreveshje, termat dhe shprehjet e meposhtme do te kene kuptimin vijues:

(a) "Barre Siguruese" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 te kesaj marreveshje.
(b) "Kolateral" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 te kesaj marreveshje.
(c) "Detyrime te Siguruara" detyrimet qe rrjedhin direkt dhe/ose indirekt per Barredhenesin/Kredimarresin ne baze te Kontrates se Kredise Bankare Nr. 4232 Rep., Nr. 1240 Kol., date 06.11.2023, Ref. Nr. 000KR-AA-2233, duke perfshire ketu edhe pagimin e çdo shperblimi, shpenzimi, demshperblimi, shpenzimet ligjore e çdo shpenzim tjeter te nenkuptuar, ne çfaredolloj monedhe, per te cilen Barredhenesi mund te behet pergjegjes ndaj Barremarresit sipas Kontrates se Kredise Bankare (e quajtur ne vijim Kontrata e Kredise).

1.2 PAVARESIA E DISPOZITAVE

Dispozitat e kesaj Marreveshje jane te pavarura nga njera-tjetra dhe deklarimi i pavlefshem apo i paekzekutueshem i ndonjeres prej tyre nga Gjykata kompetente nuk do te ndikoje vlefshmerine dhe ekzekutimin e dispozitave te tjera te kesaj Marreveshje.

1.3 NDRYSHIMET DHE HEQJA DORE

Ndryshimet dhe heqjet dore nga kjo Marreveshje do te jene te vlefshme vetem nese hartohen me shkrim dhe nenshkruhen nga te dyja palet e kesaj Marreveshjeje. Heqja dore nga ndonje prej dispozitave te parashikuara ne kete Marreveshje nuk do te interpretohet si heqje dore nga dispozitat e tjera te kesaj Marreveshje.

1.4 LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo Marreveshje do te zbatohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise dhe veçanerisht me ligjin nr. 8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese".

**NENI 2**

**BARRA SIGURUESE**

2.1 Barredhenesi nepermjet kesaj Marreveshje, krijon ne favor te Barremarresit nje barre siguruese ("Barra Siguruese") mbi pasurine e luajtshme te meposhtme (me poshte e quajtura "Kolaterali").

A2023050310139417726

1. Peng mbi pasurite e luajteshme, me te dhenat si me poshte:

- **Barre siguruese mbi 5% (pese perqind) te kuotave te kapitalit themeltar qe shoqeria 2RC SHPK zoteron ne shoqerine HP VENDRESH ENERGY SHPK regjistruar ne regjistrin tregtar mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me NIPT L39604402S, kuota te se ciles jane te reflektuara specifikisht sipas ekstraktit te QKB-se bashkengjitur kesaj marreveshje siguruese.**

- **Barre siguruese mbi 95% (nentedhjete e pese perqind) te kuotave te kapitalit themeltar qe shoqeria JDS SHPK zoteron ne shoqerine HP VENDRESH ENERGY SHPK regjistruar ne regjistrin tregtar mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me NIPT L39604402S, kuota te se ciles jane te reflektuara specifikisht sipas ekstraktit te QKB-se bashkengjitur kesaj marreveshje siguruese.**

2.2 Çdo referim ne lidhje me Kolateralin do te nenkuptoje Kolateralin apo nje pjese te tij.

2.3 Barra Siguruese ne lidhje mbi çdo pjese te Kolateralit do te krijohet menjehere sapo Barredhenesi te vertetoje titullin e pronesise mbi ate pjese te Kolateralit, siç parashikohet ne Ligjin per Barret Siguruese dhe rradha e perparesise se Barres Siguruese mbi kete pjese te Kolateralit do te caktohet nga data e regjistrimit te Barres Siguruese ne Regjistrin e barreve Siguruese sipas Nenit 4.1 me poshte.

2.4 Barredhenesi bie dakort se afati i kufizimit te barres se vendosur, eshte deri ne shlyerjen e plote te detyrimeve te rjedhura nga kontrata e kredise dhe kontrata e kredise bankare perfshire ketu cdo zgjatje afati shlyerje apo shtyrje maturimi te kredise te vendosur nepermjet anekseve te kontrates se kredise te cilat mund te lidhen ne te ardhmen ndermjet Bankes dhe Kredimarresit, pergjate te gjithe periudhes qe regjistrimi barres prodhon efekte sipas ligjit ne fuqi.

Ne, kredimarresi Shoqeria AG Hpower & Construction SHPK, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B, ne cilesine e pranuesit te barres dhe pranuesit te kesaj marreveshje siguruese, deklarojme se jemi dakort te vendoset barre siguruese mbi pronen e pershkruar me siper ne favorin e Bankes te Pare te Investimeve – Albania ShA dhe se heq dore nga çdo pretendim mbi pronen dhe te drejtat mbi te pergjate gjithe kohezgjatjes se detyrimit ndaj barremarresit.

**NENI 3**
**DETYRIMET E SIGURUARA**

3.1 DETYRIMET E SIGURUARA

Barra Siguruese do te siguroje shlyerjen, ekzekutimin dhe permbushjen e plote te te gjitha Detyrimeve te Siguruara.

3.2. VAZHDIMESIA E BARRES SIGURUESE

Barra Siguruese e krijuar sipas kesaj Marreveshje do te jete detyruese e do te mbetet ne fuqi per Barredhenesin, pasardhesit e tij apo perfitues te tjere, dhe do te perbeje nje garanci te panderprere, pavaresisht nga shlyerja e pjesshme e Detyrimeve te Siguruara dhe nuk do te cenohet apo zvogëlohet nga ndonje barre, garanci apo mjet tjeter demshperblimi qe Barredhenesi, çdo pale e trete ose organ i pushtetit gjyqesor ka dhene ne favor te Barremarresit ne lidhje me Detyrimet e Siguruara.

**NENI 4**
**REGJISTRIMI I BARRES SIGURUESE**

A2023050310139417726

Barremarresi merr persiper qe, me shpenzimet e Barredhenesit, pas nenshkrimit te kesaj Marreveshjeje, te regjistroje Barren Siguruese ne Regjistrin e Barreve Siguruese ne perputhje me Ligjin nr. 8537 date 18.10.1999 "Per Barret Siguruese", si barre siguruese te radhes se pare.

**NENI 5**

**RASTE TE MOSPERMBUSHJES**

5.1 RASTET E MOSPERMBUSHJES

Verifikimi i ndonjerit prej rasteve te meposhtem, do te konsiderohet si "Rast Mospermbushje" ne kuptimin e kesaj Marreveshjeje:

(a) mospermbushja e detyrimeve ne kohe, duke perfshire, por pa u kufizuar vetem ne detyrimet ne vijim: mosshlyerje te principalit, interesave apo ndonje shume tjeter qe perben pjese te Detyrimeve te Siguruara;
(b) falimentimi apo paaftesia paguese e Barredhenesit, apo fillimi i procedures se falimentimit apo likuidimi kundrejt Barredhenesit;
(c) proces gjyqesor qe perfundon me vendim te formes se prere dhe te ekzekutueshem kunder Barredhenesit apo kundrejt Kolateralit;
(d) pretendimi i ndonje pale te trete ne lidhje me ndonje barre siguruese kunder ndonje prone te Barredhenesit, pretendim ne baze te te cilit pala e trete kerkon ekzekutimin e barres se tij siguruese.

5.2 PERSHPEJTIMI I EKZEKUTIMIT

Ne momentin qe verifikohet ndonje nga Rastet e Mospermbushjes apo me pas, Barremarresi mund te kerkoje shlyerjen e menjehershme te nje pjese apo te te gjithe Detyrimeve te Siguruara qe nuk eshte shlyer e qe duhet shlyer, pa qene nevoja e ndonje kerkese apo njoftimi per kete.

5.3 MENYRAT E DEMSHPERBLIMIT NE RAST MOSPERMBUSHJE

Nese ndodh ndonje Rast Mospermbushje, perveç te gjitha te drejtave te tjera dhe menyrave te demshperblimit te parashikuara nga ligji, Barremarresi mund:

(a) te mbaje nje pjese ose te gjithe Kolateralin me qellim permbushjen e detyrimeve te Barredhenesit ne perputhje me kete Marreveshje.
(b) te sekuestroje, te mbledhe, te ekzekutoje, te shese, te marre hua nga te tretet duke dhene si garanci Kolateralin, t'u jape paleve te treta Kolateralin perkundrejt detyrimeve te tij, te beje gjithçka sa me siper me nje pjese apo te gjithe Kolateralin, sipas kushteve te percaktuara nga ligji per Barret Siguruese dhe mund te zbrese nga shuma e perftuar ato shpenzime qe jane perballuar ne lidhje me sekuestrimin, mbledhjen, ekzekutimin, marrjen hua nga te tretet duke dhene si garanci Kolateralin, duke i konsideruar si pjese e shumave per te cilat Barredhenesi i detyrohet Barremarresit;
(c) te kryeje procedurat per vjeljen e detyrimeve dhe te ushtroje te gjitha te drejtat per demshperblim te cilat nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

5.4 NATYRA E PAVARUR E DEMSHPERBLIMEVE

Te gjitha te drejtat, kompetencat dhe te drejtat per demshperblim qe i takojne Barremarresit sipas kesaj Marreveshje, mund te ushtrohen edhe ne menyre te pavarur dhe veçmas nga njera-tjetra, pa zevendesuar njera-tjetren dhe pa cenuar ndonje garanci te tashme apo te ardhshme te Barremarresit si dhe çdo te drejte, kompetence, apo te drejte per demshperblim te Barremarresit, sido qe te jete krijuar.

**NENI 6**

**TE PERGJITHSHME**

A2023050310139417726

6.1 NJOFTIMET

Te gjitha njoftimet apo kerkesat qe palet do t'i drejtojne njera-tjetres sipas kesaj marreveshje, duhet te behen me shkrim dhe, kur eshte e mundur, t'i dorezohen personalisht pales perkatese, ose te dergohen nepermjet postes se regjistruar ne adresen e pales perkatese, siç tregohet me poshte ose siç mund te ndryshohet:

(a) Barremarresi: Banka e Pare e Investimeve sha dega Tirane.
Adresa: "Kullat Binjake" kati 14-15, Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Tirane,Shqiperi.

(b) Barredhenesi:
Adresa: Berat, Çorovode, Komuna Qender, Buzuq , Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Pashko Vasa, Pallati Nr. 8 dhe Berat, Çorovode, Skrapar, Lagja Çlirimi, banese private, perballe tregut.

(c) Pranuesi i barres:
Adresa: Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier – Tirane, Prane Ures se Mbrostarit.

6.2 PASARDHESIT DHE PERFITUESIT

Kjo Marreveshje do te jete e detyrueshme per Barredhenesin dhe pasardhesit e tij dhe do te siguroje Barremarresin dhe pasardhesit e tij si dhe perfituesit e tjere. Kjo Marreveshje eshte e transferueshme nga Barremarresi pa marre pelqimin e Barredhenesit.

*Une Noteri, u lexoj Paleve, me ze te larte dhe te kuptueshem, tekstin e kesaj marreveshje siguruese dhe deklarimeve dhe pranimit te posaçem te kesaj marreveshje prej tyre, te cilet, pasi me deklaruan se teksti i kesaj marreveshje siguruese dhe deklarimeve dhe pranimi i posaçem i kesaj marreveshje eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time, dhe une Noteri vertetoj sa me siper sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.*

**BARREMARRES**
**Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA**

**Tsvetan Ivanov**
**CRO & Drejtor Ekzekutiv**

**Gledis Hysenaj**
**Drejtor I Biznesit**

**Perktheu:** Edua Ismaili

**BARREDHENESIT**

Joni Dyrmishi

**HP VENDRESH ENERGY SHPK**
**Adm. Joni Misir Dyrmishi**

**2RC SHPK**
**Adm. Bardhyl Hasan Hysenbelliu**

Bardhyl Hysenbelliu

Misir Dyrmishi

**JDS SHPK**
**Adm. Misir Jaçe Dyrmishi**

A20230503101394177726

**PRANUESI I BARRES**

AG Hpower & Construction SHPK
Adm. Nekida Ardjan Baha

**NOTER**

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# VERTETIMI I REGJISTRIMIT

Informacioni i meposhtem eshte i regjistruar ne Regjistrin e Barreve Siguruese

## INFORMACION I PERGJITHSHEM:

| | |
|---|---|
| Numri i Regjistrimit: | A-20231107143710403 |
| Data e Regjistrimit: | 07.11.2023 |
| Ora e Regjistrimit: | 14:37:10 |
| Kohezgjatja Regjistrimit (vite): | 10 |
| Data e Perfundimit te Regjistrimit: | 07.11.2033 |
| Numri i Dokumentit | A-323-001-1760 |
| Referenca e Perdoruesit | |

## BARREMARRESI (Kreditor):

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) BANKA E PARE E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.<br>(NUIS) K72014801J | DESHMORET E KOMBIT, KULLAT BINJAKE, 2/14 K72014801J<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 2276758<br>Fax: 2280210<br>Email: J.GJATA@FIBANK.AL |

## BARREDHENESI (Debitor):

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) HP VENDRESH ENERGY SH.P.K.<br>(NUIS) L39604402S | COROVODE, KOMUNA QENDER, BUZUQ<br>COROTAT-SKRAPAR<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) 2RC SH.P.K.<br>(NUIS) K82303007K | RR PASHKO VASA<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) JDS SH.P.K.<br>(NUIS) L38912401L | COROVODE, LAGJJA CLIRIMI, B.PRIVATE<br>BERAT-BERAT<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) AG HPOWER & CONSTRUCTION SH.P.K.<br>(NUIS) L91924026B | LAGJJA SHESH I MADH<br>FIER -FIER<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**KOLATERAL TJETER:**

NE BAZE TE MARREVESHJES SIGURUESE NR 4233 REP NR 1241 KOL DT 06.11.2023 ME NOTER BELINDA CELAJ KU VENDOSET :

-BARRE SIGURUESE MBI 5% (PESE PERQIND) TE KUOTAVE TE KAPITALIT THEMELTAR QE SHOQERIA 2RC SHPK ZOTERON NE SHOQERINE HP VENDRESH ENERGY SHPK REGJISTRUAR NE REGJISTRIN TREGTAR MBAJTUR NGA QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT ME NIPT L39604402S, KUOTA TE SE CILES JANE TE REFLEKTUARA SPECIFIKISHT SIPAS EKSTRAKTIT TE QKB-SE BASHKENGJITUR KESAJ MARREVESHJE SIGURUESE.

-BARRE SIGURUESE MBI 95% (NENTEDHJETE E PESE PERQIND) TE KUOTAVE TE KAPITALIT THEMELTAR QE SHOQERIA JDS SHPK ZOTERON NE SHOQERINE HP VENDRESH ENERGY SHPK REGJISTRUAR NE REGJISTRIN TREGTAR MBAJTUR NGA QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT ME NIPT L39604402S, KUOTA TE SE CILES JANE TE REFLEKTUARA SPECIFIKISHT SIPAS EKSTRAKTIT TE QKB-SE BASHKENGJITUR KESAJ MARREVESHJE SIGURUESE.

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

**PERSONI REGJISTRUES:**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
| --- | --- |
| (EM) BANKA E PARE E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.<br>(NUIS) K72014801J | DESHMORET E KOMBIT, KULLAT BINJAKE, 2/14<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 2276758<br>Fax: 2280210<br>Email: J.GJATA@FIBANK.AL |

**NENSHKRIMI I AUTORIZUAR:**

Emri dhe Mbiemri
EJONA SKENDERI

Fundi i Vertetimit te Regjistrimit

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER BELINDA V. ÇELAJ**
**ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.3/118**
**TEL: 0692077776**

# MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE KOLATERALI FINANCIAR)

**Nr. repertori: 4234** **Nr. koleksioni: 1242**

**Tirane më 06/11/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2023050310139599837

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE**
**ZYRA VENDORE** Tiranë
**NR.** 4234 **REP.**
**NR.** 1242 **KOL.**

## MARREVESHJE KOLATERALI FINANCIAR

Sot, me 06.11.2023, ne Tiranë, perpara meje noter Belinda Çelaj, u paraqiten personalisht palet e meposhtme, te cilet deklarojne perpara meje se me vullnetin e tyre te lire lidhin kete marreveshje kolaterali financiar si me poshte:

**KOLATERALMARRES**: **Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA**, regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar
me vendim nr. 35506, date 19.04.2006 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, NIPT K72014801J, me seli ne adresen Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tirane, e perfaqesuar rregullisht nga **z. Tsvetan Ivanov**, shtetas Bullgar, ne cilesine e CRO & Drejtorit Ekzekutiv dhe **z. Gledis Hysenaj**, shtetas Shqiptar, ne cilesine e Drejtorit te Biznesit, te dy madhore, te dy madhore, me zotesi te plote dhe per te vepruar, e quajtur ne vijim **Kolateralmarres**,

*dhe*,

**KOLATERALDHENES:** Shoqeria **HP VENDRESH ENERGY SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L39604402S, me seli dhe adrese ne Berat, Çorovode, Komuna Qender, Buzuq, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **z. Joni Misir Dyrmishi**, shtetas Shqiptar, lindur me date 26.05.1994, ne Çorovodë, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 036386211, me Nr. Personal J40526003V, leshuar ne date 03.09.2020 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakeve te shoqerise Nr. 4230 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Kolateraldhenes.**

**KOLATERALDHENES:** Shoqeria **2RC SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT K82303007K, me seli dhe adrese ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Pashko Vasa, Pallati Nr. 8, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **z. Bardhyl Hasan Hysenbelliu**, shtetas Shqiptar, lindur me date 27.05.1967, ne Potom, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 033761089, me Nr. Personal G70527056Q, leshuar ne date 01.11.2018 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr. 4227 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Kolateraldhenes.**

**KOLATERALDHENES:** Shoqeria **JDS SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L38912401L, me seli dhe adrese ne Berat, Çorovode, Skrapar, Lagja Çlirimi, banese private, perballe tregut, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **z. Misir Jaçe Dyrmishi**, shtetas Shqiptar, lindur me date 27.10.1964, ne Çorovodë, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 038819230, me Nr. Personal G41027042I, leshuar ne date 03.03.2023 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr. 4228 Rep, date 06.11.2023 madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Kolateraldhenes,**

**PRANUESI I KOLATERALIT**: Shoqeria **AG Hpower & Construction SHPK**, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B, me seli dhe adrese ne Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier – Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, perfaqesuar nga administratori i shoqerise **znj. Nekida Ardjan Baha**, shtetase Shqiptare, lindur me date 25.08.1995, ne Xibrakë, mbajtese e leternjoftimit me Nr. 033292573, me Nr. Personal J55825018O, leshuar ne date 13.01.2017 nga M.B, autorizuar me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise Nr. 4231 Rep, date 06.11.2023, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Pranuesi.**

Te cilat se bashku do te referohen ne kete marreveshje si **"Palet"**

A202305031013599837

Duke qene se palet e mesiperme kane lidhur nje Kontrate Kredie Bankare, me date 08.11.2023, me Nr. 4232 Rep. dhe Nr. 1240 Kol., Nr. Ref. 000KR-AA-2233 sipas se ciles Banka i jep Kredimarresit AG Hpower & Construction SHPK, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B dhe dorezanesit Arben Pandi Goga, nje shume prej Leke 60,500,000 (gjashtedhjete milion e peseqind mije leke), palet lidhin kete Marreveshje Kolaterali Financiar per garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Kontrate e Kredise Bankare dhe cdo shtese apo amendim apo aneks i saj, (e cila me poshte do te referohet si "Kontrata"), sipas kushteve te meposhtme:

## 1. Përkufizime

1.1 Kolaterali financiar eshte nje garanci, e cila vendoset nga Kolateraldhenesi ne posedim te Kolateralmarresit per te garantuar detyrimet financiare te Kolateraldhenesit ndaj Kolateralmarresit, perfshire ato te tanishmet ose te ardhmet, ato aktuale ose te kushtezuara apo te mundshme.

1.2 Llogaria e kolateralit eshte nje llogari e vecante ne te cilen derdhet ose transferohet kolaterali financiar, dhe nga e cila behen te gjitha veprimet me kolateralin sipas kushteve te kesaj marreveshje dhe Kontrates e Kredise Bankare.

1.3 Termat të cilat nuk janë përkufizuar në këtë Kontratë por janë përcaktuar në Kontratën e Kredise Bankare do të kenë të njëjtin kuptim që u është dhënë në Kontratën e Kredise Bankare, apo ne shtesat e amendimet e saj te mundshme.

## 2. Objekti i Marreveshjes/Kolaterali Financiar

2.1 Palet bien dakort qe detyrimet financiare qe rrjedhin nga Kontrata e Kredise Bankare, shtesat, anekset apo amendimet e saj te garantohen nga kjo Marreveshje per Kolateral Financiar.

2.2 Kolateraldhenesi merr persiper te vendose në favor të Kolateralmarresit,

a) **5% (pese perqind) te kuotave te kapitalit themeltar qe shoqeria 2RC SHPK zoteron ne shoqerine HP VENDRESH ENERGY SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L39604402S, te pasqyruara prej shoqerise ne zerat e bilancit financiar dhe te specifikuara sipas ekstraktit te QKB-se bashkengjitur kesaj marreveshje.**

b) **95% (nentedhjete e pese perqind), te kuotave te kapitalit themeltar qe shoqeria JDS SHPK zoteron ne shoqerine HP VENDRESH ENERGY SHPK regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L39604402S, te pasqyruara prej shoqerise ne zerat e bilancit financiar dhe te specifikuara sipas ekstraktit te QKB-se bashkengjitur kesaj marreveshje.**

si kolateral financiar, e cila do te referohet me poshte si "kolaterali financiar" për të garantuar ripagimin e kredisë sipas kushteve te percaktuara ne Kontrate.

Kjo prone e luajtshme do te sherbeje si kolateral financiar, garanci duke u vendosur ne radhe te pare ne favor te Bankes se Pare te Investimeve – Albania ShA, deri ne shlyerjen e plote te detyrimit ne total me vlere Leke 60,500,000 (gjashtedhjete milion e peseqind mije leke), detyrim ky qe rrjedh nga Kontrata e Kredise Bankare (e quajtur ne vijim Kontrata e Kredise), qe do te lidhet me kredimarresin AG Hpower & Construction SHPK, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B dhe dorezanesin Arben Pandi Goga.

Ne te nenshkruarit, Shoqeria AG Hpower & Construction SHPK, regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L91924026B, ne cilesine individuale te pranuesit te kolateralit te kesaj marreveshje, deklarojme se jemi dakort te vendoset barre mbi pronen e pershkruar me siper ne favorin e

A20230301013999837

Bankes te Pare te Investimeve – Albania ShA dhe se heqim dore nga çdo pretendim mbi pronen dhe te drejtat mbi te pergjate gjithe kohezgjatjes se detyrimit ndaj Barremarresit / Kolateralmarresit.

2.2 Çdo referim ne lidhje me Kolateralin do te nenkuptoje Kolateralin apo nje pjese te tij.

2.3 Kolateralmarresi pranon te marr ne posedim dhe te kete kontroll mbi kolateralin financiar.

2.4 Kolaterali financiar, shuma e percaktuar si me siper nuk mund te barresohet apo te perdoret ne marreveshje te tjera nga kolateraldhenesi si mjet garancie per detyrime te tjera te tij persa kohe eshte ne fuqi kjo marreveshje apo deri ne shlyerjen e detyrimeve te Kontrates se Kredise Bankare.

## 3. Posedimi i Kolaterialit Financiar

3.1 Kolateraldhenesi i kalon ne posedim kolaterialin financiar Kolateralmarresit nepermjet dorezimit faktik, regjistrimit ose duke e transferuar shumen e siperpermendur tek Kolateralmarresi.

3.2 Kolateralmarresi gezon mbi kolateralin financiar te drejten e posedimit si dhe cdo te drejte qe I njihet poseduesit ne baze te Kodit Civil te R.SH perfshire ketu cdo interes te mundshem te perfituar.

## 4. Detyrimet e Kolateraldhënësit

4.1 Kolateraldhënësi njeh si posedues te kolateralit financiar Kolateralmarresin dhe garanton se heq dore nga e drejta per te kryer veprime ne llogarine e kolateralit financiar, e cila kontrollohet dhe administrohet nga kolateralmarresi deri ne momentin e shlyerjes se plote te kredise ne baze te Kontrates se Kredise ne perputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara ne te.

4.2 Kolateraldhenesi njeh te drejten e Kolateralmarresit te perdore kolateralin financiar per te permbushur cdo lloj detyrimi te plote ose te pjesshem qe lind nga Kontrata e Kredise Bankare. Kjo e drejte eshte e parevokueshme deri ne momentin e shlyerjes se plote te te gjitha shumave te papaguara te Kolaterdhenesit.

4.3 Kolateraldhenesi garanton dhe njeh se cdo kalim pronesie I mundshem mbi kolateralin (dhurim, trashegimni, zgjidhje martese etj) nuk do te preke te drejtat e Kolateralmarresit mbi kolateralin financiar te percaktuara ne kete marreveshje.

## 5. Ekzekutimi i Kolateralit Financiar

5.1 Kolaterali financiar I nenshtrohet ekzekutimit te menjehershem pa pasur nevoje per te ndjekur proceduren per ekzekutim vullnetar apo te detyrueshem nepermjet gjykates dhe permbaruesve sic percaktohet per mjetet e tjera te garancise ne legjislacionin shqiptar.

5.2 Kolateralmarres ka te drejte te ekzekutoje menjehere nga llogaria e kolaterialit financiar shumen e plote apo te pjesshme te detyrimit qe rezulton I papaguar sipas Kontrates se Kredise Bankare pa pasur nevoje per te njoftuar paraprakisht Kolateraldhenesin. Me konkretisht kolateralmarrësi ka te drejte te mbaje nga llogaria e kolateralit financiar shumat e renditura si me poshte:

5.2.1 Ne fillim do të ekzekutohen /mbahen interesat, penalitetet si dhe shpenzim tjeter I mundshem;

5.2.2 Me pas do te ekzekutohen/mbahet, shuma e pashlyer e principalit të kredise.

5.3 Cdo shume e ekzekutuar nga llogaria e kolateralit financiar do te konsiderohet si shlyerje per llogari te detyrimeve te Kontrates se Kredise dhe/ose shtesave, anekseve apo amendimeve te saj.

5.4 Kolateralmarresi do te njoftoje Kolateraldhenesin debitor per cdo transferim shumash te kryera nga llogaria e kolateralit duke I bere te ditur pretendimin e tij mbi kolaterialin ne baze te Kontrates se Kredise, shtesave apo amendimeve te saj dhe kesaj Marreveshje.

5.5 Kolaterali financiar nuk I nenshtrohet ekzekutimit te kerkuar per shkak te mospermbushjeve te detyrimeve te tjera te Kolateraldhenesit, nese Kolateralmarresi nuk ka dhene pelqim paraprak. Me konkretisht kolaterali financiar do te konsiderohet I vecuar dhe I paekzekutueshem pavaresisht:

5.5.1 Hapjes se procedures per paaftesi paguese te kolateraldhenesit apo kolateralmarresit

5.5.2 Ndonje mase sigurimi, sekuestroje ose urdheri apo vendimi te ngjashem gjyqesor, permbarimor apo cdo organi tjeter ne lidhje me te drejtat dhe detyrimet e kolateraldhenesit.

## 6. Kohezgjatja e Marreveshjes se Kolateralit Financiar dhe veprimet e mbylljes

6.1 Kjo marreveshje per kolateral financiar eshte e vlefshme deri ne shlyerjen e plote te detyrimeve te Kontrates se Kredise Bankare dhe cdo shtese, aneksi apo amendimi te saj.

6.2 Kolaterali financiar sipas kesaj marreveshje mbetet ne posedimin e Kolateralmarresit deri ne shlyerjen e plote te detyrimeve te Kontrates se Kredise dhe cdo shtese, aneksi apo amendimi te saj.

6.3 Kolateralmarresi do te quaje te perfunduar kete marreveshje kolaterali financiar me pagesën e plote të detyrimeve te Kontrates se Kredise dhe cdo shtese, aneksi apo amendimi te saj. Pas shlyerjes se plote te detyrimeve te sipercituara, Kolateralmarresi do t'I vendose ne posedim Kolataraldhenesit shumen perkatese te vendosur si kolateral financiar:

6.3.1 duke ia transferuar shumen ne nje llogari tjeter te kolateraldhenesit;

*ose*

6.3. duke I dhene kolateraldhenesit akses te plote per veprime ne llogarine e kolateralit, e cila pushon se qeni si e tille pas shlyerjes se plote te detyrimeve te sipercituara.

6.4 Ne rast se Kolateralmarresi ka bere ekzekutimi te pjeshme ne llogarine e kolatralit sis eshte parashikuar ne kete marveshje, atehere kolateralmarresi do t'I ktheje ne perfundim te shlyerjes se te gjitha detyrimeve te Kontrates se kredise dhe cdo shtese apo amendimi te saj Kolateraldhenesit ne posedim, shumen perkatese e cila rezulton si balance kreditore e mbetur ne llogarine e kolateralit financiar.

## 7. Ligji I zbatueshem/Interpretimi I Marreveshjes

7.1 Kjo Marreveshje për Kolateral Financiar eshte e lidhur dhe do te konsiderohet per efekt interpretimi dhe ekzekutimi si pjesë përbërëse e Kontratës së Kredisë Bankare.

7.2 Kjo Marreveshje I nenshtrohet legjislacionit shqiptar ne pergjithesi dhe rregullimit te posacem te parashikuar ne Ligjin "Per sistemin e pagesave" Nr. 133/2013, date 29.04.2013.

7.3 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Marreveshjes dhe Kontratës se Huase, si dhe stesave apo amendimeve te saj dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

## 8. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

8.1 Palëve do te mundohen te zgjidhin mosmarrveshjet e tyre me mirekuptim ne te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane

## 9. Gjuha e Kontrates

9.1 Kjo kontrate eshte e hartuar ne gjuhen shqipe ne 3 (tre) kopje origjinale.

## 10. Ndryshimet dhe shtesat ne Kontrate

10.1 Cdo ndryshim apo shtese ne kete Kontrate do te jete i vlefshem ne rast se hartohet me shkrim dhe nenshkruhet nga te dy palet.

A20230503101395998S7

## 11. Njoftimet

11.1 Te gjitha njoftimet ndermjet paleve do te behen me shkrim ne menyren qe eshte parashikuar ne kete e marreveshje. Njoftimet, apo komunikimet do te behen ne adresat e meposhtme, te cilat do te konsiderohen te vlefshme per sa kohe asnjera nga palet nuk ka njoftuar me shkrim ndryshimin e ketyre adresave:

**Per Kolateralmarresin:** Banka e Pare e Investimeve – Albania, ShA.
Adresa: "Kullat Binjake" kati 14-15, Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Tirane,Shqiperi.

**Per Kolateraldhenesin:** Berat, Çorovode, Komuna Qender, Buzuq.
**Per Kolateraldhenesin:** Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Pashko Vasa, Pallati Nr. 8
**Per Kolateraldhenesin:** Berat, Çorovode, Skrapar, Lagja Çlirimi, banese private, perballe tregut
**Per Pranuesin e Kolateralit:** Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier – Tirane, Prane Ures se Mbrostarit.

Para meje noter, në datën e sipërpërmendur Palët nënshkruan Kontratën ose autorizuan përfaqësuesit e tyre për nënshkrimin e saj dhe une vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjet.

**PËR KOLATERALMARRËSIN**
**Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA**

**Tsvetan Ivanov**
**CRO & Drejtor Ekzekutiv**

**Gledis Hyenaj**
**Drejtor I Biznesit**

**Perktheu:** Edlira Ismaili

**PËR KOLATERALDHËNËSIN**

Joni Dyrmishi
**HP VENDRESH ENERGY SHPK**
**Adm. Joni Misir Dyrmishi**

**2RC SHPK**
**Adm. Bardhyl Hasan Hysenbelliu**
Bardhyl Hysenbelliu

**JDS SHPK**
**Adm. Misir Jaçe Dyrmishi**

**PRANUES I KOLATERALIT**

**AG Hpower & Construction SHPK**
**Adm. Nekida Ardjan Baha**

**NOTER**